

MODELIME SHKRIMI. TË SHKRUARIT FUNKSIONAL E VETJAK

Cështjet:

1. Aftësia i të shkruarit
2. Llojet e shkrimeve. Shkrimet subjektive dhe funksionale
3. Shkrimet subjektive dhe funksionale (poezia, tregimi, biografia, autobiografia, ditaret)
4. Shkrimi i letrave, shkruajmë shënime, përshkrimi i një portreti etj.

1. Aftësia i të shkruarit

Të shkruarit është një lloj i veçantë i arit të modeluarit. Ashtu si mëson një fëmijë të ecë, të flasë, të luajë në një vegël muzikore, të lexojë, ashtu mëson edhe të shkruajë. Teknika e mësimin të të shkruarit, duke u mbështetur në një tekst model është efektive për të gjitha llojet e shkrimit dhe për të gjitha llojet e komunikimit. Teknika e modelimit arrihet përmes ushtrimeve sistematike, përmes përvetësimit të modelimit në procesin e ushtrimit dhe të tejkalimit të modelit, duke e përvetësuar ë në mënyrë krijuese. Kjo kërkon kohë dhe pjekuri mendimi.

Shkrimi është quajtur një formë komunikimi dhe përfshin një dhënës, një marrës dhe një hapësirë bosh në mes, e cila duhet mbushur. Por kur ulesh të shkruash, kjo hapësirë bosh të duket shumë e madhe dhe e vështirë për t'u mbushur.

Gjatë komunikimit me shkrim ne kemi vetëm një lëndë të parë, fjalët dhe vetëm një ndihmës për t'i organizuar në mënyrë të logjikshme, pikësimin. Pra, kushdo që shkruan duhet të mësojë të shprehet saktë dhe qartë, pa ndihmën e mjeteve të tjera.

Njeriu shkruan për vete (ditar, shënime leksioni apërmbledhje libri) ose për një publik të ngushtë a të gjerë (letra ankese, raporte, artikuj gazete, tregime etj.). Përvojat e para të të shkruarit janë që në fëmijërinë e hershme. Në vitete e para të shkollës mësojmë të shkruarit mekanik duke filluar me shkronjat, rrokjet, fjalët e fjalitë deri në përdorimin e shenjave të pikësimit e më tej tek elementet e stilit. Fëmijëvë në shkolla u kërkohet të përshkruajnë kohën, të shkruajnë një kartolinë, të riprodhojnë një tregim, të shkruajnë për ngjarje jetësore, personale ose edhe të bëjnë poezi.

Mësimi i gjuhës së shkruar është domosdoshmëri, por edhe nevojë e brendshme. Nxënësit dhe studentët në shkolla shkruajnë më shumë se “janë të detyruar” (detyra shtëpie, hartime etj.), por shpesh shkruajnë edhe të nisur nga dëshira dhe në këtë rast, e zgjedhin vetë atë çka duan të shkruajnë. Mendimet mund t’i hedhin në letër në formën e një poezie, ditari, tregimi, lexuesi i parë dhe i vetëm i të cilëve janë vetë ata. Në këtë mënyrë, mësojmë shkallë-shkallë të shkruajmë në mënyrë të ndryshme.

2. Llojet e shkrimeve

Llojet kryesore të shkrimeve janë:

- a) të shkruarit përshkrues,
- b) të shkruarit tregues,
- c) të shkruarit parashtrues/shpjegues,
- d) të shkruarit argumentues/bindës

a) Të shkruarit përshkrues

Me anë të tij përshkruhen njerëz, vende, ngjarje ose sende (siç janë tani ose siç kanë qenë në të shkuarën) duke përdorur mjete gjuhësore që ndihmojnë në krijimin e një “pikturë” të qartë në mendjen e lexuesit. Fjalët zgjidhen me kujdes për të vënë në dukje tipare dhe hollësi të veçanta të sendit apo personit që përshkruhet. Karakteristikë e këtij shkrimi është edhe përdorimi i figurave të ndryshme letrare si: metafore, personifikimi, krahasimi etj.

b) Të shkruarit tregues

Qëllimi i të shkruarit tregues është të tregojë një histori, një ngjarje a një përvojë, të vërtetë ose të përfytyruar. Shembuj të këtij lloj shkrimi janë: romanet, tregimet, përrallat, fabulat, ditaret personale dhe raportet. Me anë të tyre mund të rëfelen përvoja vetjake ose jo, ndaj mund të shkruhen në vetën e parë ose të tretë. Tregimet zakonisht kanë një ose më shumë personazhe të përfshirë në një konflikt që kërkon zgjidhje. Ato përfshijnë shpesh edhe dialogun për ta bërë rrëfimin më të gjallë e më jetësor.

c) Të shkruarit parashtrues/shpjegues

Është lloj i shkrimit që shpjegon natyrën përdorimin, origjinën ose qëllimin e diçkaje. Shkrimet shpjeguese mund të paraqesin edhe një proces ose një gjendje. Të tilla janë p.sh.

broshurat që na shpjegojnë mënyrën e përdorimit të paisjeve elektro-shtëpiake, broshurat turistike ose recetat e gatimit. Në këtë grup përfshihen edhe një pjesë e mirë e letrave zyrtare.

d) Të shkruarit argumentues/bindës

Ky lloj shkrimi ka për qëllim të japë një mendim dhe të mbajë qëndrim për një çështje të caktuar, duke u përpjekur të ndikojë te lexuesi nëpërmjet përdorimit të arsytimeve të mbështetura me prova dhe argumente. Në rastë të tjera shkrimi bindës mund të përmbajë argumente dhe arsytime pro dhe kundër një pozicioni të caktuar, duke ia lënë lexuesit t'i peshojë ato dhe të marrë një vendim. Kjo mënyrë të shkruari përdoret shpesh në ese, pamflete, artikuj gazetash etj.

e) Të shkruarit krijues dhe artistik

Të shkruarit krijues ka për qëllim kryesor zbavitjen e lexuesit, por me anë të tij shpesh përcillen mesazhe të fuqishme edukative dhe shoqërore. Në të përdoret një gjuhë e pasur figurative. Me anë të tyre shkruesi shpreh ndjenjat dhe mendimet e veta ose mban një qëndrim emocional. Këtu futen poezitë, hartimet, esetë artistike etj.

Me gjithatë rrallë mund t'i gjejmë këto lloje të të shkruarit në format e tyre të pastra. Shkrimet zakonisht janë kombinim i dy ose më shumë llojeve, për shembull, rrallë mund të gjejmë një tregim ku nuk ka përshkrime, e kështu me radhë.

3. Shkrimet subjektive dhe funksionale

Me **shkrime funksionale** kuptojmë në përgjithësi shkrimet objektive, në të cilat shkruesit parashtrajnë ide dhe fakte (dhe rrallë ndjenja) nga realiteti, si raportet, esetë shkencore, letrat e punës, temat kërkimore etj. Përkundrajt tyre janë **shkrimet krijuese-subjektive**, të

cilat shprehin kryesisht ndjenjat, mendime vetjake dhe shpesh intime- të mbështetura në realitet, por të para nga një këndvështrim i brendshëm, subjektiv.

Shkrimet subjektive

Poezia

Njerëzit shkruajnë poezi për të shprehur ndjenjat e tyre: gëzim, hidhërim, dashuri, vuajtje. Kush ka provuar të shkruajë poezi e di që ajo zakonisht pas një mbushjeje shpirtërore. Megjithatë, njerëzit shkruajnë poezi edhe për të luajtur me fjalët, për të krijuar imazhe dhe për t'u argëtuar.

Shumë nxënës nëpër shkoola, që në moshë të vogël, fillojnë të eksperimentojnë me fjalët, rimat dhe vargjet. Por, poezia në të shumtën e rasteve nuk mund të shkruhet si detyrë shtëpie a klase, sepse nxënësit mund ta ndjenjë veten të vëzhguar dhe të kritikuar dhe të kenë ndrytje "të hapin shpirtin" para të tjerëve. Poezitë shkruhen në vargje dhe aty gjejmë mjete stilistikore, si rima, aliteracioni etj. Në poezi gjejmë shpesh figura të paplota, të ngarkuara me figura letrare që nxisin imagjinatën.

Cilat janë veçoritë e poezisë?

Poezia duket ndryshe. Nuk është e vështirë të dallosh një poezi. Ajo nuk zë shumë vend në faqe, ka formë të veçantë nga llojet e ndryshme të të shkruarit.

Poezia i thotë gjërat ndryshe. Gjuha e poezisë është e mbushur me figura letare është më e zgjedhur dhe më e gjallë.

Poezia tingëllon bukur. Tingujt që përsëriten ose rima, e bëjnë poezinë më të këndshme në të dëgjuar. Për hir të rimës shpesh poetëve u njihet e ashtuquajtura "e drejta e poetit" që është leja për të bërë "gabime" gramatikore ose drejtshkrimore, kur këto sjellin një tingëllim të bukur të poezisë.

Shkrimi i poezisë

Përpykjet tuaja të para për të shkruar poezi mund t'i filloni me tema shumë të thjeshta , p.sh. përshkrimin e një sendi të njohur ose që ju pëlqen. Poemat e para mund t'i mendeni edhe si lojë fjalësh. Hidhni në letër çdo gjë që vini re për objektin e zgjedhur, p.sh. një varg mbiemrash përshkrues dhe përpikuni të gjeni fjalë që rimojnë me to.

Pjesa më e madhe e njerëzve, sidomos fëmijët, zbaviten kur shkruajnë poezi, edhe nëse ato i rimojnë në mënyrë artificiale. Leximi i poezive nga shkrimtarë të ndryshëm ndihmon

në krijimin e një ndjenje poetike. Lexojini me zë. Në shumë prej tyre ndihet ritmi. Nuk është e thënë që çdo poezi të shkruhen me rimë, megjithatë rima i jep poezisë melodi.

Rishikimi

Ajo që keni shkruar ka nevojë për rishikim, ndryshime. Pyetje e mëposhtme do t'ju ndihmojnë për të bërë ndryshimet:

- A të pëlqen ajo që ke shkruar? Nëse jo, shkruaj ide të reja, bëj korrigjime në fjalë, ndrysho vendet e ideve.
- A të pëlqen mënyra se si duket poezia? Nëse jo, rishkruaje në një mënyrë të pëlqyeshme, riorganizo strofat.
- A të pëlqen mënyra se si tingëllon poezia? Nëse jo, ndoshta ka nevojë për disa fjalë që rimojnë.
- Ndrysho ose shto shenjat e pikësimit, kontrollo drejtshkrimin dhe në fund, shkruaj një kopje të pastër.

Tregimet

Në tregime ka zakonisht një situatë, një konflikt dhe një zgjidhje. Tregimet mund të jenë të shkurtra. Moshat dhe interesat e lexuesve ndikojnë në zgjedhjen e temës, nivelin e gjuhës, këndvështrimin dhe hollësitë e tregimit.

Gjtaë shktimit të tregimit është e rëndësishme që të qëndroni të përqendruar tek tema. Vendosni se cili është thelbi i tregimit dhe qëndrijini besnik atij, sepse duke u shpërndarë shumë, mund të krijohet konfuzion.

Ndërtimi i tregimit

1. *Fillimi i një tregimi është shumë i rëndësishëm.* Ai duhet të tërheqë vëmendjen e lexuesit. Në të prezanatohen personazhet dhe konflikti kryesor
2. *Prafitni konfliktin dhe personazhet.* Pjesa më e madhe e tregimeve ndërtohen rreth një konflikti të personazheve midis tyre. Numri i personazheve është i kufizuar, dy, tre, katër, pesë, por jo më shumë se lexuesi mund të ngatërrohet.
3. *Përshkrimet e qarta e bëjnë tregimin të gjallë.* Përdorni fjalë që e ndihmojnë lexuesin të dëgjojë, të nuhasë, të shijojë atë që përshkruani.
4. *Përfshini dialogun.* Fjalët me të cilat flasin personazhet me njëri-tjetrin quhet dialog. Dialogu duhet përdorur me vend, për të mbështetur idenë e tregimit.
5. *Përfundoni duke zgjidhur konfliktin.* Konflikti mund të zgjidhet në një mënyrë që është rrjedhojë logjike e ngjarjeve.
6. *Zgjidhni titullin e duhur.* Një titull i goditur e tërheq vëmendjen e lexuesit dhe krijon një ide të përgjithshme mbi historinë.

Biografite dhe autobiografite

Që në shkollë nxënësit përdorin shkrime biografike për të përshkruar ngjarje të jetës së tyre ose të njerëzve të tjerë. Lexuesit zakonisht janë mësuesit, shokët e klasës, prindërit dhe ato vetë.

Qëllimi i biografive dhe autobiografive është informimi. At zakonisht shtjellohen në mënyrë kronologjike, shkruesi zgjedh ngjarjet më të rëndësishme në jetën e tij apo të një personazhi të njohur. Në shkrimin e tyre duhet të kemi parasysh:

- Përqendrohuni tek faktet, por mos harroni të përmendni hollësitë që ngjallin interes. Ata e mbajnë lexuesin të lidhur me qëllimin e shkrimit dhe nuk lejojnë që shkrimi të bëhet monoton.
- Vendosni si do ta paraqisni temën, zgjidhni fjalë dhe situata që ndihmojnë për t'i bërë përshtypje lexuesit.
- Munduhuni të mos bëni komente të drejtpërdrejta për ndikimet pozitive apo negative të përvojave të ndryshme të personit për të cilin shkruani.
- Përdorni citime të shkrutra (nga intervista, artikuj etj.).
- Përmendni emrate njerëzve që kanë dhënë mendime për personazhin dhe përdorni fjalër e tyre pa u ndryshuar kuptimin.

Ditari

Në jetën e përditshme, njerëzit, pavarësisht nga mosha, detyra, përgjegjësia dhe profesioni, mbajnë ditar. Një ditar shkruhet zakonisht për një ngjarje nga jeta private, përshtypje, përvoja, regjistrime të thjeshta fakesh etj.

Ditari mbahet për vete dhe nuk shkruhet për t'u lexuar nga të tjerët. Ai mbahet në mënyrë progresive, me shënime të rregullta.

Mbajtja e ditarit është një proces që lejon:

- Nxitjen dhe vlerësimin e shprehive personale,
- Reflektimin e një stili të shkruari me një shkrirje të rregullt,
- Mbajtjen e distancës nga e përjetshmja tek ngjarjet e veçanta,
- Regjistrimin dhe fiksimin në ltrë të veprimeve, situatave, pasqyrimeve që lënë gjurmë,
- Njohje më të mirë të zhvillimeve me autoanalizë, të personalitetit të vet,
- Rikujtimin e së kaluarës, duke e parë nga largësia e viteve.

Ditaret mund të shkruhen në mënyra të ndryshme dhe gjatë situatave të ndryshme. Duke paraqitur vlerësime subjektive për realitetin, në kuptimin më të gjerë të fjales, këto lloje shkrimesh janë shumë relative. Ato mund të shprehin përvoja të ndryshme jetësore, të

interpretojnë dhe të reagojnë ndaj situatave të ndryshme, si dhe të bëjnë analiza lidhur me çështje të përgjithshme e të veçanta. Ditaret janë shkrime që mund të mbahen nga njerëzit e të gjitha moshave.

Për të shkrua një fletë ditari duhet:

- Shkruaj datën:....
- Drejtoju ditarit me emër: I dashur.....
- Shkruaj çfarë të ka ndodhur gjatë ditës....
- Mbylle faqen me fjalë të ëmbla....

p.sh.

10 dhjetor 2005

I dashur Pipi!

Sot ishte një ditë e keqe për mua. Bëra detyrat dhe e lashë fletoren mbi shtrat. Mami më tha ta fusja në çantë. Unë nuk e dëgjova. A e di ç'ndodhi? Popi ma bëri fletoren copë-copë. Mami më bërtiti. Vetëm ti nuk më shan mua.

Të përqafoj....deri nesër.

Si duhet të shkruhet një letër adresuar një shoku ose një shoqeje

Letrat personale dhe miqësore u shkruhen njerëzve më të dashur dhe të afërt. Qëllimi kryesor i tyre është shprehja e mendimeve dhe ndjenjave, të rejave të fundit, shpesh në mënyrë spontane. Ndaj në to duhet të përdoret një gjuhë miqësore, sikur shkruesi të ishte duke bashkëbiseduar me lexuesin, po kështu fjalori është i thjeshtë dhe përdoren shprehje të gjuhës së përditshme apo shkurtime.

Për të shkruar një letër të tillë duhet:

Në filli të letrës: E dashur.....

Në brendësi të letrës: do të shkruash se pse e dërgon letrën.

Në fund të letrës: p.sh. Dua të tkohemi sa më shpejt. Tëputh fort....

Tiranë, dt. 10.03.200.

E dashur revista “Alba”!

Unë dua të të tregoj një ngjarje që më ka ndodhur dy ditë më parë. Po luaja në shtëpi me vëllain tim. U fsheha prapa bibliotekës. Atje ishte një vazo e madhe. Babai më pa dhe më bërtiti:”Kujdes, mos thyesh vazon!”. Më vonë unë ola që andej, por vazoja ra dhe u thye. Babai u nxeh dhe më shau shumë. Ka dy ditë që babai nuk më flet. Mami më tha që vazoja ishte shumë e çmuar. Babai e kishte kujtim nga gjyshi i tij. Kjo më mërziti ende më shumë. Ju lutem, më thoni diçka për këtë. Unë ndihem shumë keq.

Me respekt, Era

Shkruajmë shënime

Shënimet miqësore janë të ndryshme me letrat, pasi nuk postohen me zarf dhe në postë, por në përgjithësi shërbejnë për të komunikuar me të afërmit, miqtë pjesëtarët e familjes. Ato mund të lihen në shtëpi, në një vend të dukshëm, drejtuar prindërve, bashkëshortëve, kolegëve të punës etj.

Ato duhet të kryejnë këto funksione:

- Të jenë të shkurtër, me ekonomi gjuhësore,
- Të thjeshta,
- Me pak informacion,
- Të qarta, të mos krijojnë keqkuptime
- Të lajmërojnë
- Të kujtojnë etj.

p.sh.

Mamush,

mos o shqetëso për mua. Jam te Arditi.

Të puth Era

Hej, Beni,

Nesër mos harro të marrësh topin me vet.

Kemi ndeshje

Tiku

Pusullat janë lloje shkrimesh të shkrutra, që dallohen nga llojet e tjera, pasi në pamje të parë përveç gjatësisë së shënimit nuk vendosin kushtëzime të tjera dhe shkruhen ndonjëherë edhe pa arsye të caktuar. Megjithatë të shkruarit e tyre nuk është aq i lehtë sa duket. Përzgjedhja e sakë e fjalëve për të dhënë sa më shumë informacion në një hapësirë të ngushtë, udhëhiqet nga parimi i ekonomisë gjuhësore. Shënimet miqësore shpesh “tolerojnë” praninë e gabimeve gjuhësore, për vetë natyrën personale të tyre, kjo do të thotë se shpesh shkruarit e këtyre shënimeve nuk i kushtojnë rëndësi aq formës së jashtme sesa përmbajtjes.

Përkruajmë shokun a shogën

Cili është shoku yt?

Si quhet?

Sa vjeç është?

Ku banon?

Si duket shoku yt?

Çfarë ngjyre i ka sytë?

Si shkon me mësimet?

Cila lojë i pëlqen më shumë?

A i pëlqen muzika, vizatimi ...etj.?

Si shkoni me njëri-tjetrin?

sA i ndani gjërat me njëri-tjetrin?

A grindeni rrallë apo shpesh? Pse?

A i tregoni të fshehta njëri-tjetrit?

Përmbledhjet

Përmbledhja është veprimtari që lidhet ngushtë me mbajtjen e shënimeve. Gjatë leximit ne përzgjedhim elementët thelbësorë dhe lëmë mënjanë ato më pak thelbësorë. Pastaj i kombinojmë mendimet tona në një ose disa paragrafë të plotë. Është mirë që në shkollë t'i praktikojmë përmbledhjet si mjet të nxënies, sepse zhvillojnë aftësitë e analizës dhe të sintezës dhe janë një ushtrim shumë i mirë i aftësive të shkruarit.

Për të bërë një përmbledhje duhet:

- Lexoni me kujdes materialin që do të përmbledhni
- Lexoni në fillim për të pasur një ide të përgjithshme. Pastaj lexoni sërish për të ndërtuar idenë kryesore dhe nënidetë.
- Lexoni titullin, shpesh idenë kryesore mund ta gjeni pikërisht aty.
- Hikoni fjalinë e parë dhe të fundit për secilin paragraf.
- Lexoni fjalitë ose fjalët me shkronja të theksuara ose të pjerrëta.